

VENDIM
Nr. 440, datë 17.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË
AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM
PËR PROFESIONISTËTE SHËNDETËSISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 394, datë 27.6.2018; nr. 164, datë 12.3.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30. 3. 2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton standardet, kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve/ organizmave private apo publike, këtu e më poshtë të quajtura “ofruesit”, që kanë si mision të ofrojnë aktivitete të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë në Republikën e Shqipërisë.

2. Akreditimi i një ofruesi është procesi i miratimit të tij si ofrues i akredituar i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

3. Institucionet përgjegjëse për procesin e akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë *Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, (në vijim, ASCK)* dhe Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm.

4. Autoriteti akreditues i ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim është ASCK-ja.

5. ASCK-ja ka këto përgjegjësi:

a) Merr në dorëzim dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofruesi, koordinon me ofruesin për plotësimin e doku-mentacionit të kërkuar dhe kryen verifikime/ inspektime për të garantuar që situata në terren përputhet me kriteret e përcaktuara dhe me deklarimet e bëra nga ofruesi. ASCK-ja bën vlerësimin e aplikimit për akreditim të ofruesit dhe harton raportin e vlerësimit;

b) Monitoron në vazhdimësi ofruesin e akredituar dhe aktivitetet e edukimit në vazhdim të organizuara prej tij. ASCK-ja duhet të kryejë monitorime, të paktën, për 10 për qind të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të çdo ofruesi të akredituar, si dhe verifikim të përmbushjes së kriterëve të tjera, të paktën, një herë në vit;

c) Në rastet kur vihen re shkelje të kriterëve, në varësi të formës dhe rëndësisë së tyre, merr masën e pezullimit të përkohshëm ose të anulimit të akreditimit të ofruesit të akredituar;

ç) Publikon listën e ofruesve të akredituar dhe statusin e përditësuar të tyre.

d) *Të publikojë periodikisht informacionet e lidhura me aktivitetet e ofruesve të akredituar nga ASCK-ja. Këto informacione t'u jepen profesionistëve të shëndetësisë dhe strukturave e institucioneve shëndetësore, për të ndikuar në pjesëmarrjen sa më të gjerë të të interesuarve.*

6. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm shqyrton ankesat e paraqitura nga ofruesit, në lidhje me akreditimin dhe vendos nëse ato merren parasysh ose jo.

7. Ofrues të akredituar të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që kanë ekspertizën dhe eksperiencën e duhur në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë dhe që plotësojnë standardet e kriteret e paraqitura në vijim në këtë vendim.

II. STANDARDET E AKREDITIMIT TË OFRUESVE

1. Ofruesi duhet të demonstrojë një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit.

2. Ofruesi duhet të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

3. Ofruesi duhet të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni të tyre para ofrimit të aktivitetit.

4. Objektivat e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të shërbejnë për të orientuar hartimin e aktivitetit sa më pranë nevojave reale për zhvillim profesional të profesionistëve të shëndetësisë.

5. Objektivat e aktivitetit të edukimit në vazhdim duhet të jenë objektiva të zhvillimit të njohurive dhe aftësive:

a) tekniko-profesionale individuale, sipas fushave të veçanta të çdo kategorie apo specialiteti (objektiva të nivelit individual);

b) për një cilësi, efikasitet, efikasitet dhe siguri më të lartë, në raport me institucionet ose shërbimet ku profesionistët e shëndetësisë punojnë;

c) për një cilësi, efikasitet, efikasitet dhe siguri më të lartë të sistemit të kujdesit shëndetësor. Këto objektiva u drejtohen të gjithë profesionistëve të sistemit shëndetësor, duke pasur, kështu, karakteristika ndërprofesionale (objektiva të sistemit shëndetësor).

6. Ofruesi duhet të bëjë një lidhje të drejtpërdrejtë e domethënëse të objektivave të paraqitura me përmbajtjen e programit dhe teknikat pedagogjike për çdo aktivitet të planifikuar prej tij.

7. ASCK-ja mund të kushtëzojë ofruesin e akredituar publik në hartimin e objektivave për aktivitete të caktuara, në varësi të përparësive dhe nevojave të sistemit shëndetësor.

8. Ofruesi duhet të garantojë pjesëmarrjen reale të profesionistëve të shëndetësisë në aktivitetin e edukimit në vazhdim. Kjo mund të realizohet në mënyra të ndryshme, si nënshkrim për pjesëmarrje, verifikim elektronik i pjesëmarrjes, formular vlerësimi për aktivitetin, i nënshkruar nga pjesëmarrësi.

9. Ofruesi duhet të garantojë vlerësimin e cilësisë së perceptuar të aktivitetit nga pjesëmarrësit, nëpërmjet një formulari të vlerësimit të aktivitetit.

10. Ofruesi duhet të sigurojë cilësinë e aktiviteteve, me anë të vlerësimit nga ekspertë të pavarur të fushave përkatëse të shëndetësisë, si dhe të vlerësojë shkallën e përvetësimit të njohurive nga ana e pjesëmarrësve, në fund të aktivitetit.

11. Ofruesi duhet t'i pajisë profesionistët e shëndetësisë me certifikatën e pjesëmarrjes, ku duhet të jenë të paraqitura edhe kreditet përkatëse.

12. Ofruesi duhet të respektojë kriteret për mbështetjen financiare dhe administrimin e duhur të promocionit tregtar, ashtu siç ato paraqiten në pikën 3, të vendimit nr. 788, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të standardeve dhe procedurave për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë".

III. KREDITET E EDUKIMIT NË VAZHDIM

1. Kreditet e edukimit në vazhdim janë tregues të sasisë dhe cilësisë së ndjekjes së aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga profesionistët e shëndetësisë.

2. Ofruesi i akredituar përcakton kreditet e edukimit në vazhdim, bazuar në kriterin 1 orë pjesëmarrje efektive (pa pushimet e ndërmjetme) me 1 kredit.

3. Një aktivitet i edukimit në vazhdim nuk mund të vlerësohet me më shumë se 50 kredite nga ofruesi i akredituar. Në rastet e aktiviteteve me kohëzgjatje efektive më shumë se 50 orë, ofruesi duhet të ndjekë procedurën e akreditimit të aktivitetit sipas vendimit nr. 788, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të standardeve dhe procedurave të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë".

4. Një aktivitet i edukimit në vazhdim nuk mund të vlerësohet me më shumë se 6 kredite në ditë.

5. Për kreditet e aktiviteteve të edukimit në distancë, ofruesi i akredituar duhet të zbatojë përcaktimet e bëra për to në vendimin nr. 788, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të standardeve dhe procedurave të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë".

6. Kreditet e edukimit në vazhdim jepen nga ofruesi, pasi ai ka kryer vlerësimin e marrjes së njohurive të duhura nga ana e pjesëmarrësit. Këtu përjashtohen aktivitetet me më shumë se 50 pjesëmarrës.

IV. KRIERET PËR AKREDITIM TË PËRKOHSHEM DHE AFATGJATË

1. Ofruesi duhet të ketë të përcaktuar "ofrimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë" në objektin e veprimtarisë së tij.

2. Ofruesi duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij në ambiente me sipërfaqe jo më pak se 50 m².

3. Ofruesi duhet të zhvillojë aktivitetet e edukimit në vazhdim në mjedise:
 - a) me ajër të kondicionuar;
 - b) me normativa të shfrytëzueshme prej 7.5-8.0 m²/pjesëmarrës dhe, bazuar në këtë normë, ofruesi deklaron numrin maksimal të pjesëmarrësve të mundshëm. Përfshirë nga kjo normativë bëhet vetëm për konferencat;
 - c) me ndriçim të plotë dhe të garantuar edhe për raste emergjente;
 - ç) të pajisura me aparaturat/mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit.
4. *Ofruesi duhet të ketë një përvojë të provueshme nga ASCK-ja ose nga institucione të tjera akredituese në një vend tjetër të BE-së ose OECD-së prej të paktën 1 (një) viti në fushën e edukimit në vazhdim në Shqipëri dhe me jo më pak se 50 aktivitete të akredituara në fushën e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.*
5. Ofruesi duhet të provojë besueshmëri ekonomike, financiare, nëpërmjet bilancit të vitit të fundit.
6. Ofruesi duhet të provojë që ka burimet njerëzore që garantojnë stabilitet të veprimtarisë së tij dhe cilësi në organizimin e menaxhimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Këtu duhet të përfshihen:
 - a) koordinatori shkencor përgjegjës për konceptimin dhe planifikimin e aktiviteteve;
 - b) komiteti shkencor, që bën miratimin e planit të aktiviteteve, përfshirë programet dhe lektorët. Komiteti shkencor duhet të ketë, minimalisht, tre pjesëmarrës;
 - c) dy persona me kohë të plotë: një profesionist kompetent për edukimin në vazhdim, përgjegjës për zbatimin dhe sigurimin e mbarrëvajtjes së aktiviteteve, dhe një person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe informacionit.

V. PROCESI I AKREDITIMIT

1. Ofruesi, bazuar në fushën e tij të ekspertizës dhe eksperiencës, mund të aplikojë për akreditim të kufizuar ose të pakufizuar *në shërbimin on-line, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit "e-Albania"*. Akreditimi i kufizuar mund të kërkohej për specialitete specifike të shëndetësisë, për kategori të veçanta të profesionistëve të shëndetësisë ose për lloje specifike aktiviteteve të edukimit në vazhdim, si aktivitete institucionale, aktivitete të edukimit në distancë etj.
2. Procesi i akreditimit fillon me aplikimin për akreditim të përkohshëm. Ofruesi duhet të ngarkojë *në shërbimin on-line, që ofrohet nga ASCK-ja, nëpërmjet portalit "e-Albania"* kërkesën për akreditim të përkohshëm dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
3. ASCK-ja, brenda 6 muajve nga data e marrjes në dorëzim të aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues, duhet të:
 - a) verifikojë plotësimin dhe vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga ofruesi;
 - b) kërkojë dokumentacione plotësuese, nëse është rasti, apo të kryejë monitorime (inspektime) në vendndodhjen e ofruesit.
4. Akreditimi i përkohshëm është i vlefshëm për një periudhë 24-mujore.
5. Pas një periudhe prej 12 muajsh, nga marrja e akreditimit të përkohshëm, ofruesi mund të aplikojë për akreditim afatgjatë, duke përditësuar dokumentacionin e dorëzuar gjatë akreditimit të përkohshëm dhe duke e plotësuar atë me një raportim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të kryera gjatë kësaj periudhe.
6. ASCK-ja, brenda 6 muajve nga data e aplikimit për akreditim afatgjatë:
 - a) vlerëson dokumentacionin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, të zhvilluara nga ofruesi gjatë periudhës së akreditimit të përkohshëm, dhe verifikon përmbushjen e kriterëve të tjera;
 - b) kryen monitorime në mjediset e ofruesit, për të verifikuar përmbushjen e kriterëve që lidhen me to.
 - c) merr vendim për akreditim të përkohshëm/ ose jo të ofruesit.
 - ç) harton një raport vlerësimi me gjetjet e konstatuara nga shqyrtimi i dokumentacionit e nga monitorimet dhe merr vendim për akreditimin afatgjatë/ose jo të ofruesit, i cili është i vlefshëm për një periudhë prej 5 vjetësh.
7. Për rinovimin e akreditimit afatgjatë, ofruesi duhet të dorëzojë në ASCK aplikimin për rinovim të akreditimit, jo më vonë se 8 muaj nga data e mbarimit të tij.
8. ASCK-ja, brenda 6 muajve nga data e aplikimit për rinovim të akreditimit, kryen detyrat e përcaktuara, harton raportin e vlerësimit dhe merr vendim për akreditim/ose jo të ofruesit për një periudhë prej 5 vjetësh.

VI. PROCESI I MONITORIMIT TË OFRUESIT TË AKREDITUAR

1. Çdo vit, ASCK-ja duhet të kryejë monitorime të paktën 10 për qind të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të organizuara nga ofruesi i akredituar, për të garantuar zbatimin e kritereve gjatë zhvillimit të aktiviteteve. *Ofruesi i akredituar duhet të njoftojë ASCK-në 3 (tri) ditë përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij.*

2. ASCK-ja kryen verifikim të përmbushjes së kritereve të tjera, të paktën një herë në vit.

3. Pas monitorimit dhe/ose verifikimit, ASCK-ja harton një raport monitorimi/verifikimi, ku paraqiten gjetjet e monitorimit/verifikimit, shkeljet e vërejtura, rekomandimet për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe afatet kohore respektive.

4. ASCK-ja paraqet raportin e monitorimit/ verifikimit në Bordin e Edukimit të Vazhdueshëm një herë në vit. Ky raport i dorëzohet, gjithashtu, edhe ofruesit të akredituar.

VII. REFUZIMI, PEZULLIMI DHE ANULIMI I AKREDITIMIT

1. Në rastet kur ASCK-ja nuk i vlerëson të përmbushura kriteret dhe standardet e kërkuara, merr vendim për refuzimin e kërkesës për akreditim të këtij ofruesi dhe ia bën atij me dije, duke paraqitur motivet e refuzimit.

2. Në rastet e refuzimit të kërkesës për akreditim, ofruesi ka të drejtë të riaplikojë pas një periudhe prej 3-muajsh.

3. Në rast se ASCK-ja, gjatë procesit të monitorimit të ofruesit të akredituar, konstaton shkelje të kritereve dhe standardeve të edukimit në vazhdim, merr vendim për:

a) pezullimin e përkohshëm të akreditimit, për një periudhë deri në 12 muaj;

b) anulimin, në rastet e shkeljeve të rënda apo në rast të mospërmbushjes së standardeve, pas periudhës së pezullimit.

4. Gjatë procesit të monitorimit:

4.1 konsiderohen shkelje të rënda:

a) moszhvillimi i aktivitetit të deklaruar, pa njohim paraprak në ASCK;

b) shkeljet e kritereve për mbështetjen financiare, sipas përcaktimeve të pikës 3, të vendimit nr. 788, datë 22.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të standardeve dhe procedurave të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”;

c) konstatimi i më shumë se tre shkeljeve të lehta;

ç) të gjitha shkeljet që nuk konsiderohen të rënda janë shkelje të lehta.

4.2 konsiderohen shkelje të lehta:

a) ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat cenojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përllogaritjen e krediteve të miratuara;

b) mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trainuesve në aktivitet;

c) përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose tregtar;

ç) keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe i krediteve të njohura prej tij;

d) vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;

dh) shkelje të kritereve të përshkruara në pikat 2 e 3, të vendimit nr. 788, datë 22.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”.

5. Në rastet e anulimit të akreditimit, ofruesi ka të drejtë të riaplikojë pas një periudhe prej 12-muajsh.

VIII. E DREJTA E ANKIMIT

Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim kanë të drejtë të ankohen pranë Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm për vendimin e akreditimit brenda 30 ditëve, nga momenti i marrjes dijeni për të. *Çdo ankesë paraqitet në shërbimin on-line, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit “e-Albania” dhe shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështesin ankimin.* Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm shqyrton raportin e vlerësimit dhe, kur ankesat janë të mbështetura, i reflekton në raportin përfundimtar dhe në vendimin e akreditimit.

IX. TARIFAT E AKREDITIMIT PËR OFRUESIT E EDUKIMIT NË VAZHDIM

Tarifat për akreditimin e ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë, si më poshtë vijon:

1. 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për akreditimin e përkohshëm të ofruesit;

2. 100 000 (njëqind mijë) lekë për procedurat e akreditimit afatgjatë dhe të rinovimit të akreditimit.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë në proces shqyrtimi nga struktura përkatëse e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, në kohën e paraqitjes së tyre.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi